



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1765/2 Prot.

Durrës, më 29.10.2019

VENDIM

Nr. 61, datë 29.10.2019

PËR

"MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSIVE, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS".

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, shkresës nr.5467 prot, datë 28.10.2019 të FE, shkresës nr.625 prot, datë 28.10.2019 të FSP, shkresës nr.117prot, datë 28.10.2019 të FASTIP, shkresës nr.341 prot, date 28.10.2019 të FTI, shkresës së FSHPJ, Bordi i Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 29.10.2019,

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për studentë të cilët vijnë në studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve dhe vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë sipas listës bashkëlidhur të hartuar nga komisioni i verifikimit të bursave, 9 studentë, efekti financiar 810.000 (lekë)
2. Efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për shpërndarjen e bursave për këta studentë, për vitin akademik 2019 – 2020 të miratuar në pikën 1 të këtij Vendimi, do të përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit (granti) i miratuar , nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitin 2019 dhe 2020, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - o Administratori
 - o Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetar i Bordit të Administrimit
Ilirjana NANO



TABELA PERMBLEDHËSE MBI NUMRIN E STUDENTEVË TE CIKLIUT TE PARE TE CILET PERFITOJNE BURSE DHE EFEKTI FINANCIAR PER VITIN AKADEMIK 2019-2020

Shkresa referuese	Fakulteti	Numri I studenteve te cilet perfitojne burse per vitin 2019-2020	Efekti financiar per vitin akademik 2019-2020 (ne leke)	KRITERI			
				Studente qe vijne nga familje qe trajtohen me ndihme ekonomike	Studente qe jane me aftesi te kufizuara	Studente qe kane statusin "jetim"	Studente te shkelqyer
Shkresa nr. 1024/3 dt. 28.10.2019 e FSHPJ	FSHPJ	-	-				
Shkresa nr. 5467 dt. 28.10.2019 e FE	FE	-	-				
Shkresa nr. 341 dt. 28.10.2019 e FIT	FIT	-	-				
Shkresa nr. 625 dt. 28.10.2019 e FSP	FSP	1	90,000	1			
Shkresa nr. 117 dt. 28.10.2019 e FASTIP	FASTIP	8	720,000				8
TOTALI		9	810,000	1	-	-	8

